



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE



ENIC-NARIC

rruga për njohjen e diplomave të huaja



European
Commission



unesco

**Projekti i financuar nga Këshilli i Evropës mbi zbatimin e
Konventës së Lisbonës – Mbështetje për Qendrat ENIC**

Manual

Udhëzime për njohjen e kualifikimeve
të huaja

Dzenan Omanovic
ENIC BiH

Udhëzime për njohjen e kualifikimeve
të refugjatëve, personave të zhvendosur
dhe personave në situata të njëjta
me refugjatët

Redouane EL ALAMI
ENIC FRANCE

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	4
Metodologjia	5
Struktura e Manualit	6
Sigurimi i informacionit	6
Verifikimi i Plotësisë së Dosjes	7
Verifikimi i institucionit dhe/ose programit të studimit	7
Institucione të panjohura, por legjitime	11
Arsimi transnacional	12
Diploma të përbashkëta	13
Verifikimi i dokumenteve	17
Vlerësimi i kualifikimit	20
Rezultatet e Vlerësimit	23
Komunikimi i rezultatit të procedurës	24

Hyrje

Më 11 prill 1997 në Lisbonë, Portugali, u nënshkrua Konventa e Këshillit të Evropës/UNESCO mbi Njohjen e Kualifikimeve në Arsimin e Lartë në Rajonin Evropian (ETS Nr. 165, 1997, më tutje Konventa e Lisbonës). Në vitet në vijim Konventa e Njohjes së Lisbonës nënshkruhet dhe ratifikohet prej të gjithave vendeve evropiane dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanadaja, Australia, Zelanda e Re dhe Izraeli. I vetmi vend anëtar i rrjetit ENIC/NARIC që nuk e ka ratifikuar Konventën e Njohjes së Lisbonës është Greqia.

Gjatë analizës së tekstit të Konventës së Lisbonës, vihet re se ajo përfaqëson një dokument të përgjithshëm formal, i cili përcakton parimet dhe dispozitat kryesore të procedurës së njohjes brenda vendeve anëtare të rrjeteve ENIC/NARIC. Megjithatë, dokumenti nuk përcakton, në detaje, procedurën e njohjes. Në vitet në vijim, dokumente ndihmëse të Konventës së Lisbonës u përshtatën nga Komiteti i Konventës së Lisbonës¹, për të patur rekomandime më të detajuara, që do të shërbejnë si udhëzues për qendrat e rrjetit ENIC/NARIC dhe organet e tjera njohëse për zbatimin e procedurave të njohjes, me qëllim akesin në tregun joformal të punës, si dhe arsimimin e mëtejshëm në institucionet e arsimit të lartë.

Nga ana tjetër, Konventa e Lisbonës parashikon gjithashtu procedurat e njohjes akademike me synim edukimin e mëtejshëm, të cilat nuk do të përfshihen në këtë Udhëzues. E rëndësishme është të theksohet se procedurat e njohjes akademike janë bazuar në njohjen e kompetencave të fituara gjatë gjithë arsimit edhe jashtë programeve të studimit dhe jo mbi të drejtat që ka kualifikimi në vendin e origjinës.

Pjesa tjetër e procedurës së njohjes është pothuajse e njëjtë, atëherë ky Udhëzues mund të përdoret edhe nga institucionet e arsimit të lartë, si mjet informacioni shtesë nga zyrtarët akademikë.

Qëllimi kryesor i këtij manuali është t'u lehtësojë procedurat e njohjes së kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë, stafit të ENIC, Qendrës së Republikës së Shqipërisë, pra Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Procedurat e njohjes në qendrën ENIC të Republikës së Shqipërisë, që vepron si pjesë e Qendrës së Shërbimeve Arsimore të Republikës së Shqipërisë, duhet të sigurojnë cilësinë e të gjitha procedurave të njohjes që kryhen nga aplikantët në Qendrën ENIC, e cila gjithashtu e ka këtë si një parakusht për zbatimin e plotë të Konventës së Lisbonës në Republikën e Shqipërisë.

Qendra e Shërbimeve Arsimore është një ent publik që vepron nën përgjegjësinë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në Shqipëri, misioni i së cilës është të sigurojë shërbimet në fushën e arsimit të përgjithshëm, veçanërisht në arsimin e lartë dhe të sigurojë akses publik në të dhënat e arsimit të lartë.

Qendra e Shërbimeve Arsimore funksionon në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë 80/2015, datë 22 qershor 2015 dhe kuadrin tjetër ligjor në lidhje me arsimin sipas fushës së tij specifike të veprimtarisë.

¹https://www.enic-naric.net/page-enic-naric_reference_documents

Objekti i veprimtarisë së Qendrës së Shërbimeve Arsimore është ofrimi i shërbimeve për qytetarët, IAL-të, institucionet e tjera dhe të tretët në fushën e arsimit. Në këtë kontekst, Qendra e Shërbimeve Arsimore vepron si qendër ENIC e Shqipërisë, misioni kryesor i së cilës është njohja e kualifikimeve të marra jashtë Republikës së Shqipërisë.

Qendra ENIC, Sektori i Njohjes së Diplomave (SENJOD), kryen veprimtarinë e tij pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe është përgjegjës për të ofruar shërbime njohjeje për të gjithë shtetasit shqiptarë që janë diplomuar jashtë Shqipërisë, ose shtetasit e huaja që duan të njohin diplomat e tyre dhe kërkojnë të studiojnë, ose të punësohen në Republikën e Shqipërisë. Stafi përbëhet nga 3+1 punonjës; 3 vlerësues kredencialesh + përgjegjësi i sektorit. Për sa i përket numrit të aplikimeve, ky numër po rritet çdo vit. Në vitin 2023 janë paraqitur gjithsej 1600 aplikime dhe 1200 vendime njohjeje janë lëshuar nga qendra.

Metodologjia

Metodologjia e përdorur për këtë Manual bazohet në botimin e dytë të *Manualit të Zonës Evropiane të Njohjes*² (Manuali *European Area of Recognition* "EAR") i botuar në vitin 2023. Ky manual është përgatitur si pjesë e projektit Erasmus +, Zbatimi i Njohjes Automatike në rrjete (I-AR). Të gjitha qendrat ENIC/NARIC kanë dhënë kontributin e tyre në këtë manual.

Botimi i dytë i manualit EAR është vetëm një version i ri, i manualit origjinal të EAR, i botuar në vitin 2012, i cili paraqet mjetet praktike dhe gjithëpërfshirëse për profesionistët e njohjes dhe palët e tjera të interesuara në Rrjetet ENIC-NARIC dhe në të gjithë Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA). Manuali i EAR-it është gjithashtu baza për zhvillimin e "Standardeve & Udhëzimeve" të ENIC/NARIC, si një instrument vetëvlerësimi dhe rishikimi nga kolegët për rrjetet e ENIC-NARIC, të miratuara nga Rrjetet ENIC/NARIC në vitin 2019. Ky instrument lejon qendrat për të vlerësuar përputhjen e tyre praktike me LRC dhe për të përmirësuar e për të identifikuar fushat në procedurat e njohjes së çdo qendre ENIC/NARIC.

Manuali i EAR-it synon t'u mundësojë vlerësuesve të kredencialeve, një mjet praktik për t'i ndihmuar ata në punën e tyre të përditshme të njohjes, në rrjetet ENIC/NARIC. Qëllimi kryesor i këtij manuali është të ofrojë udhëzime për procedurën e njohjes bazuar në botimin e dytë të Manualit të EAR-it si dhe në përvojën afatgjatë të ekspertëve në procedurat e njohjes që do të përdoren për të gjithë vlerësuesit e diplomave në qendrën ENIC në Shqipëri.

Struktura e Manualit

Duke qenë se qëllimi kryesor i këtij manuali është të udhëzojë vlerësuesit e kredencialeve në qendrën ENIC në Republikën e Shqipërisë, për një analizë më e detajuar mbi dispozitat kryesore të Konventës së Lisbonës dhe parimet kyçe në njohjen e kualifikimeve të huaja, të arsimit të lartë do të theksohen:

- promovimi i mobilitetit të studentëve dhe akademikëve,
- respektimi i autonomisë institucionale të institucioneve të arsimit të lartë,

²https://www.nuffic.nl/sites/default/files/2023-08/1.%20EAR%20Manual%202023_2nd%20edition.pdf

- njohja objektive e kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë, pa asnjë formë diskriminimi,
- njohja e kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë dhe periudhave të studimit në mënyrë fleksibël (vetëm dallimet e rëndësishme mund të çojnë në mosnjohje),
- të drejtën e aplikantit për ankimim.

Udhëzuesi do të ndjekë shtatë hapat kyç në procedurat e njohjes, si më poshtë:

1. Sigurimi i informacionit.
2. Verifikimi i plotësisë së dosjes.
3. Verifikimi i institucionit dhe/ose programit të studimit.
4. Verifikimi i dokumenteve.
5. Vlerësimi i kualifikimeve.
6. Rezultatet e vlerësimit.
7. Komunikimi i rezultatit të procedurës.

Pas prezantimit të procedurës së përbashkët të njohjes, udhëzimi do të trajtojë njohjen e kualifikimeve të refugjatëve dhe dhënien e disa rekomandimeve lidhur me to.

Sigurimi i informacionit

Procesi i njohjes së kualifikimeve të arsimit të lartë, fillon me paraqitjen e një kërkesë për njohje nga aplikanti. Përpara dorëzimit të aplikimit, aplikanti duhet të informohet për të gjitha aspektet kryesore në procedurat e njohjes, e cila i referohet informacionit bazë për kuadrin ligjor që rregullon fushën për të cilën kërkohet njohja, informacionin bazë në lidhje me autoritetin e njohjes, duke përfshirë informacionin e kontaktit, metodologjinë e punës së organit të njohjes, detyrimet e aplikantit gjatë procedurës së njohjes, mënyrën e informimit të aplikantit gjatë procedurës së njohjes, afatet nominale të procedurës së njohjes, të drejtat e aplikanti me vendimin pozitiv pas përfundimit të procedurës së njohjes, si dhe të gjithë të dhënat e tjera që do të sigurojnë plotësisht transparencën e procedurës, si një nga parimet kryesore të Konventës së Lisbonës.

Në këtë drejtim, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet informacionit në plotësimin e formularit të aplikimit si dhe dokumentacionit që aplikanti paraqet bashkë me aplikimin.

Formulari i aplikimit duhet të përmbajë të gjithë informacionin e nevojshëm për vlerësim. Megjithatë, duke marrë parasysh se një procedurë njohjeje profesionale në fakt bazohet në të drejtat të cilat aplikanti i ka në vendin e origjinës, përmbajtja e programit të studimit dhe të gjitha informacionet e tjera në lidhje me kompetencat nuk duhet të jenë pjesë e dosjes së aplikimit.

Duke marrë parasysh që dokumentet e falsifikuara po bëhen gjithnjë e më të popullarizuara në mbarë botën, e nëse fushëveprimi i punës ofron mundësinë për të verifikuar vërtetësinë e çdo kualifikimi të arsimit të lartë, është e arsyeshme që pjesa thelbësore e dosjes së aplikimit të verifikohet me pëlqimin e aplikantit, për të verifikuar të gjitha arritjet e tij/saj akademike. Kjo është shumë e rëndësishme për të shkurtuar procedurën e njohjes, sepse nëse aplikanti nuk e ka nënshkruar pëlqimin për verifikimin e të dhënave, procedura e njohjes do të zgjasë më shumë, sepse aplikanti duhet të kontaktohet në vijueshmëri. Nga ana tjetër, praktika pozitive në punën e rrjeteve ENIC/NARIC ka treguar se numri i aplikantëve me dokumente false ka rënë pikërisht për shkak të ndërjegjësimin të aplikantëve për përgjegjësinë penale me të cilën ngarkohen për deklaratë të rreme.

Për sa i përket dokumentacionit të nevojshëm për njohjen e një kualifikimi të arsimit të lartë, një çështje shumë e rëndësishme për t'u theksuar është niveli i kualifikimit, për të cilin kërkohet njohja. Nëse aplikohet për njohjen e kualifikimit të ciklit të dytë dhe të tretë, ose program pasuniversitar i vendeve që janë pjesë e sistemit të Bolonjës dhe nëse diploma nuk shoqërohet nga suplementi, ose në të nuk ka informacion mbi arsimin e lartë të mëparshëm, është jashtëzakonisht e rëndësishme të kërkohen diplomat e mëparshme, përfshirë kohëzgjatjen e programit të studimit dhe kreditet ECTS të fituara, nëse jepen. Kjo mund të ndihmojë aplikantin nëse informacioni rreth arsimit të fituar më parë do t'i nevojitet tregut të punës, kështu që është shumë e rëndësishme të specifikohet në vendimin e njohjes.

Verifikimi i Plotësisë së Dosjes

Pas kryerjes së aplikimit, hapi pasues në procedurën e njohjes, duhet të jetë verifikimi nëse aplikimi i përmban të gjitha dokumentet e kërkuara. Nëse aplikimi ka mungesë dokumentesh, aplikanti duhet të njoftohet dhe duhet t'i lihet një afat kohor i arsyeshëm për të plotësuar aplikimin. Në të njëjtën kohë, aplikanti duhet gjithashtu të informohet se afati për përfundimin e procedurës së njohjes do të shtyhet, për një periudhë të njëjtë kohore, me afatin në të cilin aplikanti duhet të dorëzojë dokumentet shtesë.

Siç përcaktohet edhe në edicionin e dytë të Manualit të EAR-it, aplikantëve duhet t'u sigurohet mbrojtja e të dhënave personale, duke mos u dhënë asnjë të dhënë personale palëve të treta (përfshirë institucionin që kryen aplikimin) pa pëlqimin me shkrim të aplikantit.

Verifikimi i institucionit dhe/ose programit të studimit

Verifikimi i institucionit dhe/ose programit të studimit është edhe çështja më e rëndësishme në procedurën e njohjes. Në shumicën e rasteve, nëse njohja refuzohet, arsyeja është statusi i institucionit lëshues, i cili është konsideruar si dallimi thelbësor. Për këtë arsye, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet këtij kapitulli dhe modaliteteve të ndryshme të ofrimit të aktiviteteve të arsimit të lartë që do të eksplorojnë, si në vendet anëtare të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë, vendet anëtare të rrjeteve ENIC/NARIC, ashtu edhe në vendet e tjera. Një rëndësi e veçantë do t'i kushtohet njohjes së kualifikimeve të fituara nëpërmjet programeve të përbashkëta.

Hapi i parë në procedurën e njohjes është të përcaktohet nëse institucioni i arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën, njihet në vendin e origjinës. Duhet pasur parasysh se kërkesat lidhur me statusin e institucionit të arsimit të lartë në vendin e origjinës janë shumë më të shpeshta në rastin e njohjes profesionale, sesa në rastin e njohjes akademike. Meqenëse njohja akademike bazohet në njohjen e kompetencave të fituara, dhe jo mbi njohjen formale të një diplome, statusi i institucionit për njohje akademike nuk është aq i rëndësishëm në lidhje me njohjen profesionale, pasi që në njohjen profesionale, të drejtat e fituara garantojnë me statusin e institucionit në vendin e origjinës. Kjo do të thotë se sistemi i sigurimit të cilësisë konfirmon kompetencat e fituara të mbajtësit të një diplome të tillë. Kjo është arsyeja, se përse në procedurat e njohjes profesionale duhet kushtuar më shumë vëmendje në përcaktimin të statusit të institucionit të arsimit të lartë. Në këtë aspekt, duhet

pasur parasysh se cilësia e arsimit të fituar si dhe metoda e sigurimit të cilësisë është ndryshuar në raport me kohën kur është marrë kualifikimi individual i arsimit të lartë.

Nëse flasim për Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë, para tranzicionit për procesin e Bolonjës, sistemi i sigurimit të cilësisë ishte i garantuar nga vetë shteti ose institucionet e arsimit të lartë.

Megjithatë, me nënshkrimin e Deklaratës së Bolonjës dhe kalimit të arsimit të lartë në sistemin e Bolonjës, të gjitha vendet evropiane, pranuan detyrimin për të zbatuar sistemin e sigurimit të cilësisë. Në lidhje me këtë, Rrjeti Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (në tekstin e mëtejshëm ENQA³) u themelua në vitin 2000 për të promovuar bashkëpunimin evropian në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, me synimin kryesor për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë evropian. Ajo gjithashtu vepron si një forcë shtytëse kryesore për zhvillimin e sigurimit të cilësisë në të gjithë vendet nënshkruese të deklaratës së Bolonjës.

Në vitet që pasuan, janë mbajtur edhe Konferencat Ministrore të Zonës së Arsimit të Lartë Evropian dhe në Konferencën e mbajtur në vitin 2015 në Yerevan⁴, u përshtatën Standardet dhe Udhëzimet e rishikuara për Sigurimin e Cilësisë në Zonat Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG), duke afruar kuadrin e brendshëm dhe të jashtëm ligjor në Sigurimin e Cilësisë së Arsimit të Lartë.

Për të zbatuar ESG, të gjitha vendet pjesëmarrëse kanë krijuar agjenci për sigurimin e cilësisë, të cilat monitorojnë nga jashtë institucionet e arsimit të lartë dhe programet e studimit që këta të fundit ofrojnë. Kështu u krijua Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë (EQAR⁵), me synim thelbësor regjistrimin e atyre agjencive që punojnë në vijimësi të kuadrit të dakordësuar (ESG) për të siguruar cilësinë e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit.

EQAR lançoi Bazën e të Dhënave të Rezultateve të Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë (DEQAR) në 2018 për të siguruar akses të drejtpërdrejtë në raportet dhe vendimet e EQAR-it nga agjencitë e regjistruara.

Duke marrë në shqyrtim gjithçka që u përmend më parë, nëse agjencia e sigurimit të cilësisë është anëtar i rregullt i ENQA dhe programi i studimit është i regjistruar në bazën e të dhënave DEQAR, në atë rast nuk ka dyshim për cilësinë e arsimit të lartë.

Në rastin kur agjencia është anëtare e plotë e ENQA dhe programi i studimit figuron në DEQAR, ekzistojnë variacione të ndryshme të sistemit të sigurimit të cilësisë, në vende specifike që janë anëtare të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe vlerësuesit e kredencialeve në ato raste duhet të jenë të familjarizuar me sistemin arsimor dhe metodën e sigurimit të cilësisë së secilit vend. Në disa shtete, akreditimi institucional ka përfunduar, por akreditimi i programeve të studimit ende nuk ka përfunduar ose është kryer akreditimi i programeve të studimit vetëm për programe studimi individuale, të zgjedhura rastësisht nga procedura e akreditimit. Në përgjithësi, nëse vendi ka një anëtarësim të plotë në ENQA, nuk është e nevojshme të shpenzohet shumë kohë në kontrollin e akreditimit të programit të studimit, nëse nuk është lehtësisht i verifikueshëm. Megjithatë, disa institucione të arsimit të lartë, përveç kualifikimeve, që janë pjesë e sistemit të arsimit formal, p.sh., kualifikimet kombëtare, ofrojnë lloje të ndryshme të zhvillimit profesional dhe të tilla kualifikime

³ <https://www.enqa.eu/about-enqa/>

⁴ <https://www.ehea.info/page-ministerial-conference-yerevan-2015>

⁵ <https://www.eqar.eu/>

përgjithësisht nuk njihen, sepse nuk plotësojnë kriteret e përgjithshme të sistemit të sigurimit të cilësisë. Për shembull, në Spanjë⁶ ekziston një diplomë e quajtur “*titulo oficial*” që njihet nga shteti dhe kurrikula është e miratuar nga Ministria e Arsimit. Kjo diplomë përfshin emrin e Mbretit Felipe VI të Spanjës, emrin e Rektorit dhe identifikon gradën si të tillë. Nga ana tjetër, ekziston edhe një diplomë e quajtur “*titulo propio, Titulos propios*” që nuk konsiderohet si pjesë e strukturës formale të arsimit të lartë, pasi nuk ka njohje akademike nga Ministria e Arsimit. Për më tepër, diploma të tilla nuk ofrojnë akses për punësim në institucionet shtetërore, por mund të pranohen si të barabarta me titujt zyrtarë me qëllim punësimin në sektorin privat. Shembuj të tillë ka Zvicra, Gjermania dhe vende të tjera të Bashkimit Evropian që nënkupton domosdoshmërinë e familjarizimit me sistemin e arsimit të lartë, të vendit të origjinës, nga vlerësuesi i kualifikimeve.

Shumica e vendeve të Bashkimit Evropian kanë një anëtarësim të plotë në ENQA. Vende të tjera evropiane që janë pjesë e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë janë kryesisht të përkushtuara për anëtarësim të plotë në ENQA dhe më vonë në DEQAR dhe janë në faza të ndryshme të përmbushjes së kërkesave për të aplikuar për anëtarësimin e plotë, ose kanë aplikuar tashmë. Gjithashtu, vende të ndryshme kanë modele të ndryshme të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë. Shumica e vendeve kanë kriter akreditimin institucional të institucioneve të arsimit të lartë dhe çdo programi studimi, ndërsa disa vende, përveç dy akreditimeve të përmendura, zbatojnë edhe akreditimin e secilës njësi organizative individuale (fakulteti, instituti, akademia...). Kjo me siguri mund të sjellë probleme në procedurat e njohjes, për shkak se institucioni i arsimit të lartë ka akreditim institucional dhe/ose akreditim të programit të studimit dhe/ose akreditimit të njësisë organizative, për këtë arsye hulumtimet shpesh dhe asistencë nga autoritetet kompetente, në këto raste, janë të nevojshme.

Një problem tjetër që mund të lindë është periudha e ndërmjetme midis dy akreditimeve institucionalë dhe/ose akreditimeve të programit të studimit dhe/ose akreditimit të njësisë organizative. Ka qasje të ndryshme në raste të tilla dhe një kërkim shpesh është patjetër i nevojshëm. Duke marrë parasysh se institucionet e arsimit të lartë në të shumtën e rasteve nuk kanë reshtur së ofruari shërbimin si dhe faktit që periudha ndërmjet dy akreditimeve është më pak se një vit akademik dhe se vonesa lidhet më së shumti me problemet organizative që lindin në procedurat e akreditimit, rekomandohet që në procesin e njohjes në të tilla raste, të jemi sa më fleksibël dhe t'i njohim të këto diploma. Për shembull, ekziston një precedent në Republikën e Serbisë⁷ ku institucioni i arsimit të lartë ka akredituar dy programe studimi, ndërsa akreditimi institucional u mohua në 2011, ndërkohë institucionet e arsimit të lartë janë me procedurë të akredituara deri në 2015. Gjithashtu, duke marrë parasysh që Republika e Serbisë zhvillon procedurat e akreditimit për njësinë organizative, nuk mund të marrim informacion për akreditimin e fakulteteve në veçanti. Është gjithashtu konfuz fakti, se të gjitha programet e studimit të akredituara, janë në nivel universitar, ndërsa diplomat lëshohen nga njësi individuale organizative (fakultetet). Kjo sjell konkluzionin se në raste të tilla, ku dallimet janë të dukshme, mund të konkludohet me vendimin negativ të njohjes (mosnjohje).

⁶ <https://acei-global.blog/2015/05/28/spain-understanding-and-evaluating-the-titulo-propio/>

⁷ <https://www.nat.rs/wp-content/uploads/2023/10/Vodi%C4%8D-za-studente-25.10.2023.pdf> (f. 82)

Një shembull tjetër janë institucionet e arsimit të lartë në Bosnje dhe Hercegovinë, ku për shkak të strukturës komplekse të Bosnjë-Hercegovinës, akreditimi institucional i institucioneve të arsimit të lartë ka filluar që në 2013, por pa një afat përfundimi, sepse të gjitha institucionet e arsimit të lartë punojnë me licencë. Licenca lëshohet nga organi kompetent arsimor, pasi institucioni i arsimit të lartë ka përmbushur kërkesat minimale për të ushtruar aktivitetin si institucion arsimor, duke pasur një listë programesh studimi që ofrohen nga institucioni.

Duke mos pasur një afat për përfundimin e procedurave të akreditimit, edhe diplomat e lëshuara nga institucionet e licencuara të arsimit të lartë, janë dokumente arsimore të vlefshme në Bosnje-Hercegovinë. Shumica e të diplomuarve në këto institucione arsimore të licencuara punësohen më së shumti në Bosnje-Hercegovinë ndaj këto institucione të arsimit të lartë nuk kanë interes për të marrë akreditim institucional. Ndërkohë, disa institucione të arsimit të lartë e ndërprejnë ofrimin e shërbimit pa kryer procedurën e akreditimit institucional kështu që këto raste sigurisht që paraqesin sfidë për njohjen e të tilla kualifikimeve jashtë vendit. Ky është edhe rasti kur kualifikime të tilla nuk mund të konsiderohen se plotësojnë standardet minimale të sigurimit të cilësisë dhe gjithashtu mund të shfaqen dallime thelbësore në procedurën e njohjes.

Statusi i diplomave të lëshuara në rajone të tjera që nuk i përkasin Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe rrjeteve ENIC/NARIC, është shumë sfidues. Rajonet e tjera të botës, përgjithësisht nuk kanë institucione të përbashkëta që do të trajtonin edhe sistemin e sigurimit të cilësisë si ENQA dhe EQAR, duke lënë të kuptohet se nuk kanë standarde dhe metoda të njëjta për kryerjen e procedurës së akreditimit. Për më tepër, përveç Konventës së Lisbonës, ekzistojnë pesë konventa të tjera rajonale mbi njohjen⁸. Edhe pse është vënë re një progres i qenësishëm në zbatimin e Konventës në Azi dhe Paqësor, dhe gjithashtu përparime në zbatimin e Konventës në Amerikën Latine dhe Karaibe, nuk ka qendra të ngjashme me qendrat ENIC/NARIC të cilat mund të ndihmojnë në vendosjen e statusit të institucioneve të arsimit të lartë në këto rajone të botës. Kjo do të thotë se për këto vende do të përdoren mjete të ndryshme informacioni.

Mjeti i parë informues mund të jenë faqet zyrtare të internetit të ministrive kompetente për arsimin e lartë, ku mund të gjendet informacion për akreditimin institucional dhe/ose të programeve të studimit. Disa probleme që shfaqen, mund të jenë se faqja e internetit e ministrisë kompetente, nuk ka një version në anglisht, atëherë nevojiten përpjekje shtesë për të vendosur mbi statusin e akreditimit.

Mjeti i dytë i informacionit është Baza e të Dhënave Botërore e Arsimit të Lartë⁹, një bazë unike të dhënash që ofrojnë informacion të besueshëm mbi sistemet e arsimit të lartë dhe institucionet në mbarë botën, e mbështetur nga Shoqata Ndërkombëtare e Universiteteve dhe UNESCO. Kjo bazë të dhënash përmban informacione rreth njohjes/licencimit/akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë, por edhe rreth programeve të studimit që ofrojnë. Ajo përditësohet rregullisht në bazë të informacionit që ofrohet nga autoritetet kompetente në të gjitha vendet.

⁸ <https://www.enic-naric.net/page-recognition-conventions>

⁹ <https://whed.net/home.php>

Në përgjithësi, duhet të siguroheni gjithnjë që burimi i informacionit të jetë zyrtar dhe i përditësuar, sepse shpeshherë sistemet arsimore ndryshojnë dhe kështu ndryshon statusi i një institucioni dhe/ose programi i studimit.

Mjet tjetër shumë i dobishëm informacioni që mund t'ju ndihmojë në përcaktimin e statusit të një institucioni të arsimit të lartë, është faqja e internetit të qendrës NARIC të Holandës (NUFFIC), veçanërisht seksioni¹⁰ mbi përshkrimin e sistemeve arsimore në shumicën e vendeve të botës, duke përfshirë linqe të dobishëm mbi faqet kombëtare të internetit, ku gjendet informacion mbi akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programet e studimit.

Ka disa shërbime që duhet të paguhen për të marrë informacionin e duhur rreth sistemeve arsimore dhe institucioneve të arsimit të lartë, por ato nuk do të përmenden në këtë punim, duke pasur parasysh se të gjitha shërbimet e përmendura falas, janë më se të mjaftueshme për të përcaktuar statusin e një institucioni të arsimit të lartë dhe programet e studimit.

Në fund të fundit, ndihma e qendrave ENIC/NARIC të vendeve të mëdha nuk është e papërfillshme. Vlerësuesit e kualifikimeve në ato qendra shpesh vijnë nga rajonet në të cilat gjendet institucioni që ka lëshuar diplomat, veçanërisht në rastet kur bëhet fjalë për diploma të arsimit të lartë në gjuhë të tilla si arabishtja, apo gjuhë të ngjashme. Gjithashtu, të tillë vlerësues kualifikimesh janë më të njohur me të gjitha sfidat në procedurat për përcaktimin e statusit të institucioneve të arsimit të lartë. Prandaj, të kërkuarit informacion nga qendra të tilla ENIC/NARIC është një nga mënyrat për të përcaktuar statusin e institucioneve të arsimit të lartë dhe i programeve të studimit. Kjo është shumë e rëndësishme sepse ekzistojnë udhëzime të ndryshme të cilat duhet të analizohen thellë në disa raste, për shembull, në Etiopi ekziston një kombinim i njohjes institucionale për universitetet publike (nëse emri i universitetit është në listë, të gjithë programet janë të njohura) dhe akreditimit të programeve për kolegjet në sektorin privat. Gjithashtu, në sistemin Australian të arsimit të lartë ekziston një përzierje e llojeve të ndryshme të institucioneve: jo-vetë akredituese me akreditim programesh dhe institucionesh të arsimit të lartë, vetë-akredituese që përjashtohen nga programi i akreditimit dhe kryesisht funksionojnë në bazë të sigurimit të brendshëm të cilësisë.

Institucione të panjohura, por legjitime

Ka gjithashtu disa institucione që plotësojnë të gjitha standardet e sigurimit të cilësisë, por nuk janë institucione të arsimit të lartë në nivel shtetëror. Shumica e institucioneve të tilla i referohen ofruesve të arsimit ushtarak dhe policor dhe institucioneve fetare. Për shembull, ekziston Shkolla Teologjike Ortodokse Serbe e Shën Savës, dhe bazuar në informacionin e dhënë nga qendra ENIC e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ky institucion është i njohur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nga ana tjetër, ky institucion nuk ka ambicie për t'u akredituar. Qëllimi i tij kryesor është vetëm edukimi i njerëzve për të punuar si staf në institucionet ortodokse serbe, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, megjithëse mund të përmbushte të gjitha kërkesat për të qenë një institucion i akredituar i arsimit të lartë.

Ka edhe institucione shumë të njohur arsimorë në fushën e ekonomisë ose teknologjisë së informacionit në Evropë, me programe studimi jashtëzakonisht cilësore që vlerësohen shumë nga tregu i punës, kryesisht nga kompanitë private.

¹⁰ <https://www.nuffic.nl/en/subjects/diploma/education-systems>

Institucione të tilla gjithashtu nuk kanë nevojë të akreditohen sepse të diplomuarit e tyre punësohen në sektorin privat në Evropë pa asnjë vështirësi. Megjithatë, duke respektuar arritjet arsimore të ofruesve të tillë arsimorë, njohja e kualifikimeve të tyre është mjaft e vështirë ose e pamundur, veçanërisht sepse vlerësuesit e kualifikimeve nuk mund të vlerësojnë cilësinë e tyre në mënyrë të pavarur, ata nuk kanë kompetencë apo njohuri të mjaftueshme që vlerësimet e dhëna nga këta ofrues arsimorë përmbushin standardet minimale në sistemin e sigurimit të cilësisë, në mënyrë që të vlerësohen si ofrues të akredituar arsimorë.

Një nga zgjidhjet mund të jetë ose që ofruesit e tillë arsimorë të akreditohen në një nga vendet në të cilin ata veprojnë, ose të nënshkruajnë një marrëveshje dypalëshe me vendin ku operojnë që do të njohë diplomat e tyre si kualifikime kombëtare në atë vend.

Arsimi transnacional

Bazuar në një nga dokumentet ndihmëse të Konventës së Lisbonës, *Kodi i Rishikuar i Praktikës së Mirë në Ofrimin e Arsimit Transnacional*¹¹, në Qershor 2007, ofron përkufizimin e arsimit transnacional si më poshtë (i njohur gjithashtu si arsimi ndërkuftar):

Të gjitha llojet dhe mënyrat e ofrimit të programeve të studimit të arsimit të lartë, ose grupeve të lëndëve të studimit, ose shërbimeve arsimore (përfshirë ato të arsimit në distancë) në të cilat studentët janë të vendosur në një vend të ndryshëm nga ai ku bazohet institucioni arsimor. Këto programe studimi mund t'i përkasin sistemit arsimor të një shteti të ndryshëm nga shteti në të cilin institucioni arsimor vepron, ose mund të veprojnë pavarësisht sistemit arsimor kombëtar.

Për më tepër, ekzistojnë dy lloje marrëveshjesh ligjore, financiare ose bashkëpunime të tjera të arsimit transnacional:

(a) marrëveshjet e bashkëpunimit, ku programet e studimit ose pjesë të një kursi studimi, ose shërbime të tjera arsimore, të institucionit që i ofron, lëshohen ose ofrohen nga një institucion tjetër partner;

(b) marrëveshjet jobashkëpunuese, ku programet e studimit, ose pjesë të një kursi studimi, ose shërbime të tjera arsimore, ofrohen drejtpërdrejt nga institucioni ofrues.

Kjo do të thotë se njohja e kualifikimeve të dhëna në arsimin transnacional mund të kërkojë një ekzaminim më të afërt të programit dhe statusit të institucioneve të përfshira si dhe udhëzimeve në lidhje me njohjen/akreditimin e arsimit në vendet e origjinës dhe ato pritëse. Praktika në procedurat e njohjes brenda rrjeteve ENIC/NARIC ka treguar se është shumë më e vështirë të verifikosh dhe të njohësh diplomën e marrë në një marrëveshje bashkëpunimi sepse nuk ka një sistem sigurimi cilësie mjaftueshëm të qartë dhe të publikuar që të shuajë dyshimet në cilësinë e arsimit të ofruar. Kjo është veçanërisht problematike nëse institucioni nuk i përket sistemit të arsimit të vendit ku zhvillohet arsimi i lartë.

Në rastin e marrëveshjeve jo bashkëpunuese, nevojitet vetëm të kontrollohet statusi i institucionit ofrues të arsimit në vendin vendas dhe në vendin ku arsimi është ofruar.

Duke marrë parasysh statusin ligjor të ofruesve të arsimit transnacional, dallimet në legjislacion mund të ndikojë në vlerësimin e arsimit transnacional dhe kualifikimeve të tilla. Për shembull, në disa vende, legjislacioni kërkon që institucioni partner duhet të njihet në vendin ku ndodhet, ndërsa në vendet e tjera kjo nuk është një kërkesë.

¹¹ https://www.enic-naric.net/Upload/Documents/Revised_Code_of_Good_Practice_TNE.pdf

Në rastin e marrëveshjeve jo bashkëpunuese, qëndron pothuajse e njëjta situatë.

Shembulli i mirë i arsimit transnacional mund të jetë Universiteti i Evropës Qendrore në Vjenë. Ky universitet është i akredituar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga Komisioni i Shteteve të Mesme për Arsimin e Lartë¹². Për më tepër, fillimisht ky universitet u akreditua në Budapest nga autoritetet kompetente të arsimit në Hungari dhe më pas u zhvendos në Vjenë duke u akredituar nga autoritetet kompetente arsimore në Austri. Interesant është fakti se ky universitet, edhe pse është një universitet amerikan, operon me ECTS. Për shkak të të gjithë faktorëve të lartpërmendur, nuk ka asnjë pengesë për njohjen e një arsimimi transnacional.

Si përfundim bazuar tek arsyet e lartpërmendura, njohja e arsimit transnacional duhet të kryhet rast pas rasti. Edhe pse dokumenti ndihmës i Konventës së Lisbonës, Kodi i Rishikuar i Praktikës së Mirë të Ofrimit të Arsimit Transnacional përcakton që institucioni transnacional duhet të jetë i akredituar/regjistruar në të dy vendet, dhe duke marrë parasysh faktin që legjislacioni i vendeve individuale ku kryhet arsimi nuk kërkon që institucioni i arsimit të lartë të ofrojë arsimim në atë vend (për shembull, disa universitete amerikane në Lindjen e Mesme), në procedurat e njohjes profesionale, të gjitha këto fakte duhet të merren parasysh dhe vlerësuesit e kualifikimeve duhet të jenë maksimalisht fleksibël, duke mundësuar njohje edhe në rastet kur institucioni i arsimit të lartë është i akredituar vetëm në vendin e tij.

Diploma të përbashkëta

Bazuar në një nga dokumentet ndihmëse të Konventës së Lisbonës, Rekomandim i rishikuar për njohjen e diplomave të përbashkëta dhe Memorandumi shpjegues¹³, shkurt 2016, shprehim përkufizimin e mëposhtëm të diplomave të përbashkëta dhe programe të përbashkëta të studimit:

Diploma e përbashkët i referohet një kualifikimi të arsimit të lartë të dhënë së bashku nga të paktën dy institucione të arsimit të lartë, në bazë të një programi të përbashkët. Një diplomë e përbashkët lëshohet në një dokument të vetëm. Programi i përbashkët i referohet një programi studimi të zhvilluar, të koordinuar dhe të ofruar nga të paktën dy institucione të arsimit të lartë së bashku dhe që përfundon me dhënien e një diplome të përbashkët.

Ka kaq shumë modalitete të ndryshme të zbatimit të programe të përbashkëta, si në kushtet e statusit të institucioneve pjesëmarrëse në programin e përbashkët, ashtu dhe në kushtet e kualifikimeve që jepen. Rasti më i thjeshtë në procedurën e njohjes është kur të gjithë institucionet e arsimit të lartë në programin e përbashkët janë të akredituara dhe kur programi i përbashkët është i akredituar në të gjitha vendet ku ndodhen institucionet e arsimit të lartë. Në këtë rast nuk kërkohet kontroll i mëtejshëm. Nëse nuk është ky rasti, atëherë sigurisht që duhet treguar fleksibilitet më i madh, veçanërisht duke marrë parasysh se kuadri legjislativ në shumicën e vendeve nuk rregullon ofrimin e programeve të përbashkëta dhe dhënien e diplomave të përbashkëta.

¹² <https://www.chea.org>

¹³ https://www.enic-naric.net/Upload/Documents/Revised_Recommendation_Recognition_Joint_Degrees_2016_ENGLISH.pdf

Në këtë punim do të paraqesim vetëm raste të përgjithshme të zbatimit e programeve të përbashkëta të studimit dhe njohjen e diplomave të marra pas përfundimit të programeve të përbashkëta të studimit (kualifikim i përbashkët, diplomë e dyfishtë, diplomë dyshe, diplomë e shumëfishtë).

Praktikat e shkuara kanë treguar se në shumicën e rasteve konsorciumi i institucioneve të arsimit të lartë që marrin pjesë në programin e përbashkët të studimit përbëhet nga institucionet publike të arsimit të lartë brenda Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe programet e përbashkëta të studimit të financuara nga Erasmus Mundus¹⁴, kështu që nuk ka dyshim mbi statusin e institucioneve të arsimit të lartë. E vetmja çështje për analizë është akreditimi i programit të studimit, sepse në disa vende korniza ligjore për akreditimin e programeve të përbashkëta të studimit ende nuk është zhvilluar mjaftueshëm. Megjithatë, pasi këto janë kryesisht institucione publike të arsimit të lartë, suksesi i të cilave garantohej nga vendet në të cilat ato operojnë, në procesin e njohjes duhet të tregohet niveli maksimal i fleksibilitetit.

Megjithatë, ka edhe situata kur një institucion i arsimit të lartë nuk është i akredituar ose një ofrues arsimor që nuk i përket sistemit të arsimit të lartë, shfaqet si pjesë e konsorciumit. Në këtë rast, kërkohet të shfaqet niveli më i mundshëm i fleksibilitetit në mënyrë që të përcaktohet nëse një institucion i tillë arsimor ka vetëm një pjesë të programit të tij si pjesë e programit të përbashkët të studimit apo mësimdhënia jepet nga vetë institucioni arsimor. Nëse ky nuk është rasti, atëherë nuk duhet të kryhen kontrole të mëtejshme dhe kualifikimet e përbashkëta duhet të njihen, vetëm nëse ka dallime thelbësore të rëndësishme në akreditimin e programit të përbashkët të studimit që mund të çojnë në mosnjohjen e kualifikimit.

Në përgjithësi, kjo zonë është një zonë gri e njohjes. Si shembull, ishte një rast interesant që u diskutua në serverin e listave të rrjeteve ENIC/NARIC. Interesant është gjithashtu fakti që qendrat ENIC/NARIC në përgjithësi nuk e komentuan këtë rast. Diploma është *Master javnih nabavki / Master në Menaxhimin e Prokurimit Publik* nga Universiteti i Beogradit / Universiteti i Romës Tor Vergata.

Më poshtë janë detajet rreth diplomës të marra nga suplementi i saj:

¹⁴ <https://erasmusgeneration.org/mobility/erasmus-mundus-joint-master-degrees>

<i>ITALY</i>	<i>SERBIA</i>
3rd cycle qualification (EQF 8) professional-oriented course that does NOT give access to further studies (no access to PhD) this type of course does not belong to the general requirements established at national level, but it is offered under the autonomous responsibility of each university.	2nd cycle qualification compared to master program (EQF 7),
Access to this program- 2nd cycle HE (Laurea Magistrale)	Access to this program- 1st cycle HE (4-year Bachelor Degree)
NO access to PhD- this type of course does not belong to the general requirements established at national level, but it is offered under the autonomous responsibility of each university.	Access to 3rd cycle HE programs (PhD)

<i>ITALIA</i>	<i>SERBIA</i>
Kualifikimi i ciklit të 3- të (KSHK 8), kurs i orientuar profesionalisht që nuk jep akses në studime të mëtejshme (nuk jep akses në studimet doktorale), ky tip kursi nuk bën pjesë tek dispozitat e përgjithshme që kërkohen në nivel kombëtar, por ofrohet nën përgjegjësinë autonome të çdo universiteti.	Kualifikimi i ciklit të 2- të, i njëjtë me programin Master (KSHK 7).
Aksesi në këtë program- cikli i 2-të HE (Laurea Magistrale)	Aksesi në këtë program- cikli i 1-rë HE (Diplomë Bachelor 4 vjeçare)
Jo akses në PhD- ky lloj kursi nuk i përmbush detyrimet e përgjithshme në nivel kombëtar, por ofrohet nën përgjegjësinë autonome të secilit prej universiteteve.	Akses në ciklin e 3-të të programeve HE (PhD)

Zgjidhja e mundshme për këtë rast do të ishte si më poshtë:

Fakt është se kualifikimi i arsimit të lartë është pozicionuar në nivelin 8 krahasuar në EQF në Itali, por edhe ky kualifikim nuk i jep akses për studime doktorale në Itali. Ka kualifikime të ngjashme të arsimit të lartë në ish-Jugosllavi me titullin “magistar nauka”, dhe një kualifikim i tillë është pozicionuar si kualifikim i nivelit 8 krahasuar me EQF në

Republikën e Kroacisë, Republikën e Sllovenisë dhe Bosnje-Hercegovinës, por në të vërtetë një kualifikim i tillë është pozicionuar në nivelin 7 krahasuar me EQF në Republikën e Serbisë, Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Republika e Malit të Zi. Ajo që i karakterizon të gjithë ata në të gjitha vendet është se një kualifikim i tillë jep akses në programin e studimeve të doktoraturës dhe madje edhe njihet si pjesa e programit të studimeve PhD që mund të rezultojë në shkurtimin e programeve të studimit.

Duke marrë parasysh gjithçka të përmendur dhe duke respektuar dispozitat e Konventës së Lisbonës dhe dokumentet ndihmëse të saj, të cilat përcaktojnë se në procedurën e njohjes, të drejtat që diploma gëzon në vendin e origjinës janë bazë për njohjen e saj dhe jo krahasimi me diploma e ndryshme kombëtare, të gjitha këto informacione do të ishin pjesë përbërëse e vendimit të njohjes, duke ia lënë tregut kombëtar të punës për të shqyrtuar nëse është e pranueshme për punëdhënësit ta pranojnë atë si kualifikim të nivelit 7 ose 8 krahasuar me EQF. Kjo do të thotë se pjesë e përmbajtjes së një vendimi njohjeje do të ishte:

Kualifikimi është cikli i tretë i arsimit të lartë në Itali që i përgjigjet nivelit 8 i EQF në Itali, është cikli i dytë i arsimit të lartë në Serbi çfarë korrespondon me nivelin 7 të EQF në Serbi dhe korrespondon me nivelin 7 ose 8 në Shqipëri.

Verifikimi i dokumenteve

Krahas përcaktimit të statusit të dhënies së institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit që ofrojnë, duhet kryer një kontroll i origjinalitetit të dokumenteve të paraqitura që është çështja më sfiduese në procedurën e njohjes.

Listën e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit e gjeni në faqet zyrtare të internetit të ministrive ose agjencive kompetente për sigurimin e cilësisë, por në shumicën e rasteve lista e të diplomuarve nuk gjendet në faqen zyrtare të internetit të institucioneve të arsimit të lartë, ose organeve arsimore të sigurimit të cilësisë. Kjo çështje është gjithashtu e lidhur me të gjitha qasjet për të vendosur njohjen automatike brenda Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë, duke marrë parasysh se pa databazën e duhur të të gjithë të diplomuarve, procedura automatike e njohjes nuk mund bëhet e mundur.

Në dy dekadat e fundit, veçanërisht me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë së informacionit, ka shumë dokumente të falsifikuara të paraqitura për njohje. Praktika ka treguar se ekzistojnë dy lloje të ndryshme dokumentesh të falsifikuara të dorëzuara, "diplomat e falsifikuara" dhe "akreditimi i falsifikuar". "Diplomat e falsifikuara"¹⁵ i referohet një biznesi të paraqitur si një institucion arsimor, i cili shet diploma false pa asnjë kërkesë për studime (serioze), kërkime ose hulumtime.

Fabrikat e diplomave funksionojnë pa ndonjë njohje nga autoritetet kompetente kombëtare, ose pa akreditim të ligjshëm, edhe pse ato mund të kenë një licencë për të vepruar si biznes. Ato mbeten një shqetësim serioz për vlerësuesit e diplomave dhe rekrutuesit.

¹⁵ https://www.nuffic.nl/sites/default/files/2023-08/1.%20EAR%20Manual%202023_2nd%20edition.pdf (Page 49)

"Akreditimi i falsifikuar" i referohet një organizate akreditimi të panjohur, zakonisht joekzistente që pretendon të ofrojë akreditim pa pasur asnjë autorizim për ta bërë këtë. Në shumë raste fabrikat e akreditimit janë të lidhura ngushtë me falsifikatorët e diplomave.

Praktika ka treguar gjithashtu se është shumë më e lehtë të zbulosh një institucion mashtrues në arsimin e lartë krahasuar me një kualifikim fals i arsimit të lartë, veçanërisht nëse është përdorur modeli origjinal i kualifikimit. Nëse modeli origjinal i kualifikimit nuk është përdorur, është më e lehtë të zbulohet, sepse logoja e institucionit, titulli i kualifikimit, fontet, personat nënshkrues ndryshojnë krahasuar me formatin origjinal. Rekomandohet që shembuj formatesh të tillë të jenë, në një bazë të dhënash të brendshme për të gjitha kualifikimet të mëparshme, në mënyrë që vlerësuesi i diplomave të mundet më lehtësisht të kuptojë nëse një diplomë është e falsifikuar apo jo. Nëse përdoret modeli origjinal dhe emri i mbajtësit të diplomës është i njëjtë, në këtë rast e vetmja mundësi është të kërkoni nga institucioni i arsimit të lartë, lëshues i diplomës, të vërtetojë vërtetësinë e kualifikimit të arsimit të lartë.

Një aspekt shtesë shumë i rëndësishëm që duhet theksuar lidhur me kontrollin e autenticitetit të diplomës është fakti se a kemi kohë dhe burime njerëzore për të kontrolluar çdo diplomë? Duke rënë dakord që çdo diplomë duhet të kontrollohet, kjo do të thotë se duhen më shumë njerëz në zyrë dhe më shumë kohë për të përfunduar çdo procedurë njohjeje. Nga ana tjetër, duhet të merret parasysh se cilat janë pasojat kryesore nëse diploma nuk kontrollohet dhe çfarë mund të shkaktojë mbajtësi i një diplome të tillë në tregun e punës. Kjo do të thotë se nëse fusha e studimit lidhet me ushtrimin e profesionit, i cili mund të ketë ndikim në shëndet apo në sigurinë publike (p.sh. mësuesit, doktorët), rekomandohet të kontrollohet autenticiteti i çdo diplome. Për shembull, brenda rrjeteve ENIC/NARIC, ka shumë diploma të falsifikuara nga India, kryesisht diploma të tilla lëshohen nga institucione të cilat nuk gjenden në listën zyrtare të institucioneve të arsimit të lartë të njohur në Indi. Kjo kërkon që të kemi një listë të përditësuar, e cila duhet të monitorohet rregullisht. Për sa i përket procesit të verifikimit, rekomandohet që procedura të kryhet nga qendra ENIC/NARIC.

Institucionet e arsimit të lartë duhet të kontaktohen drejtpërdrejt, brenda saj gjithashtu, njësia organizative e cila është përgjegjëse për ofrimin e programeve të studimit. Praktika ka treguar nëse nuk është kështu, njësitë e tjera organizative apo bordi administrativ i institucionit nuk janë përgjigjur ose nuk ua kanë përcjellë pyetjen përgjegjësve, në njësinë organizative (fakultet, akademi, institut). Procesi i verifikimit mund të ndërlihet me sigurimin e informacioneve të tjera që nevojiten për të përfunduar procedurën e njohjes. Mund të jetë një rast kur mungojnë disa informacione në aplikimin e paraqitur, si p.sh. informacioni mbi akreditimi e programit të studimit dhe kohëzgjatjes së tij, periudha e studimit jashtë vendit, procedurat e ndjekura përpara regjistrimit (numri i krediteve të marra), etj. Sugjerohet të mos kontaktohet me aplikantin por t'i kërkojë institucionit të arsimit të lartë më shumë informacion mbi diplomën në mënyrë që të përshpejtohet procedura e njohjes.

Në disa raste, një institucion ofruer i arsimit të lartë kërkon një pagesë për të dhënë informacionin e duhur në procesin e verifikimit ose nuk përgjigjet për një periudhë të arsyeshme kohore. Në raste të tilla, asistenca e qendrës ENIC/NARIC të vendit në të cilin institucioni i arsimit të lartë funksionon është mëse e dobishme.

Për të shkurtuar këtë proces verifikimi, disa baza të të dhënave online mund të jenë mjet informacioni shtesë. Ka disa vende që përdorën mundësinë e zhvillimit të teknologjisë moderne të komunikimit me qëllim për ta bërë këtë verifikim më të shpejtë dhe më pak të kushtueshëm në favor të të diplomuarve të tyre.

Është i mundur verifikimi i vërtetësisë së dokumentit duke përdorur një link të veçantë. Shembulli konkret i një përpjekjeje të tillë është Republika e Moldavisë¹⁶, duke u drejtuar te linku, duke zgjedhur opsionin *Edukimi i përgjithshëm*, futjen e numrit të regjistrimit dhe numrit serial, mund të verifikohet emri i titullarit të diplomës. Krahas këtij verifikimi diploma ka edhe burime specifike për verifikimin në vend të dokumenteve (shembujve)¹⁷.

Nëse të gjitha këto mjete informacioni nuk mund të mjaftojnë për të marrë informacionin e duhur, ekziston gjithashtu një mundësi për të kërkuar ndihmën e aplikantit/saj. Kjo do të thotë se aplikantët mund të japin detajet e kontaktit të njerëzve në njësinë e tyre organizative, të cilët mund të sigurojnë të gjithë informacionin e rëndësishëm për vlerësim. Për këtë arsye, rekomandohet që tek formulari i aplikimit, të ketë një fushë të posaçme lidhur me informacionin e personave të kontaktit dhe të dhënat e tyre, të plotësuara nga aplikanti. Praktika ka treguar gjithashtu se është shumë e rrallë që të ketë parregullsi të tipit mungesë e pulave zyrtare dhe/ose nënshkrime, shtrembërime, nënshkrime të skanuara, gjuhë joformale, gabime drejtshkrimore, terminologji jokonsistente, , elemente shkronjash jokonsistente në diplomat zyrtare. Nëse ky është një rast i tillë, këto parregullsi mund të jenë një tregues i falsifikimit, prandaj kontrolli shtesë është me rëndësi të madhe.

Arsye shtesë për kontroll të dyfishtë mund të jetë një format lëshimi. Disa vende kanë marrë një model standard të diplomës së arsimit të lartë dhe nëse formati i kualifikimi ndryshon, kjo me siguri mund të çojë në një dokument të falsifikuar.

Vlerësimi i kualifikimit

Vlerësimi i kualifikimit është një element kyç i procesit të njohjes së diplomave të arsimit të lartë. Qëllimi për të cilin kërkohet njohja mund ndryshojë dhe të përcaktojë mënyrën se si vlerësohet një diplomë. Bazuar në këtë, vlerësimi i kualifikimeve të arsimit të lartë duhet të ndahet në:

- vlerësimi lidhur me vazhdimësinë e arsimit në institucionet e arsimit të lartë, i cili bazohet në krahasimin e kompetencave të kualifikimeve të mëparshme ose periudhat e studimit të kryera në një tjetër institucion të arsimit të lartë, me qëllim arsimimin e mëtejshëm në një program të caktuar studimi dhe në përgjegjësi ekskluzive të institucioneve të arsimit të lartë. Në këtë rast, vlerësimi kryhet nga njësitë organizative ose departamentet, si organet ekskluzivisht kompetente për vlerësimin e rezultateve të fituara të të nxënit.

- vlerësimi lidhur me aksesin në tregun joformal të punës, i cili bazohet në njohjen e të drejtave të cilat i gëzon në vendin e origjinës. Në përgjithësi, ky vlerësim është tema kryesore e këtij dokumenti për të cilin qendrat ENIC/NARIC, në shumicën e vendeve të rrjeteve ENIC/NARIC janë përgjegjëse, sepse nuk bazohet në vlerësimin e kompetencave, të cilat mund t'i kryejnë vetëm institucionet e arsimit të lartë, por në njohjen e të drejtave që i jep kualifikimi i arsimit të lartë mbajtësit të tij.

¹⁶ <https://ctice.md/verif>

¹⁷ https://www.nuffic.nl/sites/default/files/2023-08/1.%20EAR%20Manual%202023_2nd%20edition.pdf (f. 64-65)

- vlerësimi lidhur me aksesin në tregun formal të punës është autorizimi zyrtar për të ushtruar një profesion të caktuar. Ka të bëjë me të drejtat për ushtrimin e profesionit të rregulluar dhe kryesisht bazohet në rregullore të veçanta, nga ku, përveç kompetencave që përmban kualifikimi i dhënë, parashikohen kërkesa shtesë për ushtrimin e profesioneve të tilla. Në vendet e Bashkimit Evropian, ky legjislacion bazohet në dispozitat të Direktivës Evropiane 2005/36/EC, të ndryshuar nga Direktiva Evropiane 2013/55/BE, e cila synon të lejojë qytetarët e BE-së të transferojnë kualifikimet e tyre në shtetet anëtare të BE-së. Ajo funksionon në parimin që një profesionist i kualifikuar në një shtet anëtar, është i kualifikuar për të ushtruar të njëjtin profesion në një shtet tjetër anëtar. Ky vlerësim është jashtë objektit të dispozitave të Konventës së Lisbonës dhe kompetencave të qendrave ENIC/NARIC.

Duke marrë parasysh një ndarje vlerësimi, njohja profesionale e kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë dhe vlerësimi i tyre, është kompetencë ekskluzive e qendrave ENIC/NARIC dhe bazohet në përcaktimin e të drejtave që ka kualifikimi në vendin ku është marrë. Në përgjithësi, vlerësimi i një kualifikimi të huaj të arsimit të lartë bazohet në elementët e mëposhtëm:

- informacionin e përgjithshëm për mbajtësin e një kualifikimi të huaj të arsimit të lartë;
- statusin e ofruesit arsimor dhe programet e studimit që ofron;
- titullin e kualifikimit;
- kohëzgjatjen e programit të studimit;
- informacionin mbi një kualifikim të mëparshëm të arsimit të lartë;
- kreditet e fituara;
- nivelin e kualifikimit në vendin e origjinës, nëse kuadri i kualifikimeve ekziston, duke iu referuar Kornizës Evropiane të Kualifikimeve dhe krahasimit me një nivel kualifikimi të marrë në Republikën e Shqipërisë;
- aksesin që jep kualifikimi në lidhje me tregun joformal të punës.

Informacioni i përgjithshëm për mbajtësin e një kualifikimi të huaj të arsimit të lartë i referohet emrit të dokumentit (diplomë, certifikatë...), emrit dhe mbiemrit, një numri unik dhe datës së diplomimit.

Statusi i institucionit arsimor dhe i programeve të studimit përcaktohet duke iu referuar emrit të institucionit të arsimit të lartë dhe/ose njësisë organizative që lëshon diplomën (fakultet, akademitë, institutet...), si dhe emërtimit zyrtar të programit të studimit.

Duke analizuar dokumentet më të rëndësishme të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe Zonës Evropiane të Njohjes, është e qartë se nuk ka një përcaktim të titullit të diplomës, çka nënkupton se titulli i diplomës, edhe pse një element i rëndësishëm i vendimit të njohjes, nuk përcakton kompetencat.

Nëse titulli i kualifikimit është shkruar në grupin e gjuhëve arabe, kineze, rekomandohet të bëhet një përshtatje e tij. Për shembull, një titull japonez 文学士号 duhet të konvertohet në Bachelor të Arteve.

Një degë shkencore e programit të studimit që çon në kualifikimin e arsimit të lartë është pika kyçe e procesit të vlerësimit dhe elementi më i rëndësishëm i vlerësimit të një kualifikimi të arsimit të lartë për tregun e punës. Nëse programi i studimit që çon në kualifikimin e arsimit të lartë përbëhet nga një ose më shumë fusha shkencore, fushë shkencore ose degë shkencore, rekomandohet që të gjitha këto të shënohen në vendimin e njohjes.

Për shembull, ka programe studimi që përfaqësojnë një kombinim të ndryshëm fushash shkencore, të tilla si Ekonomia e Biznesit dhe Teknologjia e Informacionit. Në këtë rast, duke njohur kualifikimin e arsimit të lartë, të dy fushat shkencore duhet të vendosen në vendimin e njohjes.

Kohëzgjatja e programit të studimit i referohet kohëzgjatjes nominale të nevojshme të programit të studimit për përfundimin me sukses të arsimit. Kohëzgjatja e programit të studimit mund të jetë e ndryshme në lidhje me sistemin arsimor të vendit ku është marrë kualifikimi. Kështu, në vende të Lindjes së Mesme ka programe studimi bachelor që zgjasin deri në pesë vjet, por pavarësisht kohëzgjatjes së tyre, ato njihen si programe studimi bachelor. Ka edhe programe studime të integruara (brenda Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë ka programe studimi të integruara të ciklit të parë dhe të dytë) që zgjasin 6 vjet dhe ato janë kryesisht karakteristikë e grupit të shkencave mjekësore. Programe të tilla studimi edhe pse janë programe studimi universitare, njihen si cikli i dytë i arsimit të lartë. Ka edhe disa raste kur aplikanti ka shlyer të gjitha detyrimet në vetëm tre vite për shkak të ekselencës së tij/saj me përjashtim të disa lëndëve të cilat nuk janë të detyrueshme për përfundimin e programit të studimit. Edhe pse arsimi zgjat vetëm tre vjet, në këto raste diploma njihet si diplomë katërvjeçare.

Informacioni mbi kualifikimet e mëparshme të arsimit të lartë i referohet të gjitha diplomave të mëparshme që duhet të vendosen në vendimin e njohjes. Nuk zbatohet ky parim nëse një kualifikim universitar i arsimit të lartë është i njohur. Megjithatë, në rastin e njohjes së një kualifikimi pasuniversitar, është e nevojshme të merret informacion rreth arsimit të mëparshëm të lartë. Në përgjithësi, në shumicën e vendeve, një program studimi i përfunduar Bachelor dhe Master vlerësohet me 300 kredite ECTS. Ka vende të cilat pasi kanë marrë 180 kredite ECTS në programin e studimit bachelor, pasohen nga një program i studimeve master me 90 kredite ECTS. Ky parim është karakteristikë e vendeve skandinave. Edhe pse këto kualifikime do të jenë të njohura, nuk ka asnjë garanci që ato do të njihen nga tregu i punës, nëse kërkohet një diplomë Masteri me 300 kredite ECTS.

Kreditet e fituara i referohen rezultateve të të nxënimit dhe/ose ngarkesave mësimore të matura në kohë. Ato i jepen një studenti pas përfundimit me sukses të një lënde të një programi studimi dhe/ose programi të plotë studimi. Ekzistojnë sisteme të ndryshme kreditesh dhe nivele të ndryshme arsimimi në mbarë botën. Një sistem kreditesh mund të jetë i kufizuar vetëm tek një institucion, në një kontekst specifik kombëtar, ose mund të zbatohet në të gjitha sistemet e ndryshme arsimore kombëtare, siç është Sistemi Evropian i Krediteve (ECTS) i cili karakterizon pjesën më të madhe të sistemeve të arsimit të lartë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë. Duhet të theksohet se jo të gjithë sistemet dhe/ose institucionet arsimore në botë kanë sisteme kreditimi. Kjo nuk duhet të konsiderohet si një ndryshim thelbësor dhe të çojë në refuzim të njohjes së një diplome. Në të tilla raste rekomandohet të merret parasysh një periudhë e nevojshme për të përfunduar programin e studimit, numri i njësive/lëndëve për semestër, niveli i programit... Ka edhe disa vende, sistemet arsimore të të cilëve operojnë me një sistem kreditesh të ndryshme nga sistemi ECTS. Për shembull, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka një sistem kreditesh në të cilin për përfundimin e një viti studimi jepen 60 kredite amerikane, 30 kredite për semestër. Edhe pse nuk ka një ndarje të përcaktuar ndërmjet krediteve amerikane dhe krediteve ECTS, në shumicën e vendeve të rrjetit ENIC/NARIC 1 kredit i fituar në SHBA konsiderohet si 2 kredite ECTS. Nga ana tjetër, në Mbretërinë e Bashkuar ekziston një sistem kreditimi në të cilin pas përfundimit e një viti studimi, të jepen 120 kredite, 60 kredite

për semestër. Pra brenda shumicës së vendeve të rrjetit ENIC/NARIC 1kredit ECTS i fituar konsiderohet si 2 kredite të fituara në Mbretërinë e Bashkuar.

Niveli i kualifikimit në vendin e origjinës, nëse kuadri i kualifikimeve ekziston, do të marrë si referencë Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (EQF) dhe ta krahasojë me një nivel kualifikimi të marrë në Republikën e Shqipërisë, duke krahasuar kualifikimet sipas nivelit në të cilin janë pozicionuar në vendin e origjinës nga Republika e Shqipërisë, si dhe referenca e tyre sipas kuadrit gjithëpërfshirës, i cili, në rastin e njohjes profesionale, është Korniza Evropiane e Kualifikimeve për Mësimin gjatë Gjithë Jetës (EQF LLL). Korniza kombëtare e kualifikimeve (KSHK) mund të kenë numra të ndryshëm nivelesh kualifikimi, por në kushtet e njohjes, çështja më e rëndësishme është se ato duhet t'i referohen të tetë niveleve të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (EQF). Për shembull, korniza kombëtare e kualifikimeve në Slloveni¹⁸ dhe Irlandë¹⁹ ka një strukturë prej dhjetë nivelesh, me diploma Bachelor në nivelin 7 dhe 8, diploma Master në nivelin 9 dhe Doktoratë në nivelin 10, por për perspektivën e njohjes, e vetmja çështje e rëndësishme është se këto nivele i referohen përkatësisht niveleve 6-8 të Kornizës së Kualifikimeve Evropiane. Nëse vendi që ka lëshuar diplomën nuk ka një Kornizë Kombëtare Kualifikimesh, rekomandohet të krahasohen diploma të tilla sipas Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për Të mësuarit gjatë gjithë jetës, dhe Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Pasi të gjitha vendet të kenë plotësuar Kornizat Kombëtare të Kualifikimeve, krahasimi ndërmjet kornizave të ndryshme të kualifikimit do të lehtësojë krahasimin e diplomave dhe do të thjeshtësojë njohjen e diplomave në të 3 nivelet e arsimit të lartë, e si pasojë mund të realizohet dhe njohja automatike e diplomave të arsimit të lartë.

Të drejtat që të jep kualifikimi në lidhje me aksesin në tregun joformal të punës i referohen faktit nëse i diplomuari i referohet të drejtave formale në vendin e origjinës, për aq sa këto ekzistojnë dhe paraqesin rezultatet e të nxënit të vërtetuar nga kualifikimi. Nëse aplikanti duhet të kryejë ende një praktikë në mënyrë që të ketë një të drejtë të plotë për akses në tregun joformal të punës, ky detyrim duhet të shënohet edhe në vendimin e njohjes. Për më tepër, kur të drejtat formale bashkëlidhen me një kualifikim të caktuar, të huaj, në vendin e origjinës, diploma duhet të vlerësohet me synimin për t'i dhënë mbajtësit të saj të drejta formale të njëjta në Republikën e Shqipërisë, pa marrë parasysh nëse mund të ushtrojë të njëjtat të drejta në Republikën e Shqipërisë dhe duke mos i shënuar ato në vendimin e njohjes.

Rezultatet e Vlerësimit

Një nga themelet e Konventës së Lisbonës është se njohja duhet të realizohet, përveç rastit kur mund të konstatohet një ndryshim thelbësor, që mund të çojë në një vendim negativ njohjeje. Nëse nuk ka dallim thelbësor, duhet të kryet një njohje e plotë. Në dispozitat e Konventës së Lisbonës, theksohet si më poshtë: *“Kualifikimet e huaja do të njihen nëse nuk ka një ndryshim thelbësor ndërmjet kualifikimit të huaj për të cilin kërkohet njohja dhe kualifikimit përkatës të vendit pritës. Duke parë vetë përkufizimin, është e qartë se nuk përcaktohet qartë koncepti i ndryshimit thelbësor, dhe zbatimi i këtij koncepti varet nga vendi në vend.”*

¹⁸ <https://www.nok.si/en>

¹⁹ <https://www.qqi.ie/what-we-do/the-qualifications-system/national-framework-of-qualifications>

Këtu çështja e të drejtave që jep kualifikimi në vendin e origjinës është e lidhur drejtpërdrejt me konceptin e dallimeve thelbësore. Përveç verifikimit të autenticitetit të diplomave të arsimit të lartë, çështja e dallimit thelbësor, paraqet një sfidë kyçe për zbatimin e plotë të Konventës së Lisbonës. Domethënë, të drejtat që ka marrë kualifikimi në vendin e origjinës nuk mund të kontestohen, nëse legjislacioni kombëtar i vendit njohës, e zgjidh të njëjtën çështje ndryshe. Për shembull, vendet e ish-Jugosllavisë, Bosnje-Hercegovinës, Sllovenisë, Kroacisë, Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi i kanë bazuar sistemet e arsimit të lartë në gradat akademike profesionale. Duke analizuar Kornizën e Kualifikimeve Kombëtare të tyre, kualifikimi Master i Shkencave, si kualifikim para Bolonjës, është shënuar si niveli 7 në Serbi, Maqedoni të Veriut dhe Mal të Zi, ndërsa i njëjti kualifikim, është shënuar si i nivelit të 8 në Bosnje-Hercegovinë, Slloveni dhe Kroaci.

Bazuar në këtë, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi nuk mund ta ulin këtë kualifikim Master i Shkencave që vjen nga Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Sllovenia në nivelin 7 bazuar në legjislacionin e tyre dhe ta njohin si kualifikimin “Magistar nauka”, ashtu siç ai njihet në vendet e përmendura. Nga ana tjetër, edhe pse kualifikimi “Magistar nauka” është i nivelit 8 në Bosnje-Hercegovinë, Slloveni dhe Kroaci, këto vende duhet ta njohin një kualifikim të tillë që vjen nga Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi si kualifikim i nivelit 7, bazuar në të drejtat e vendeve përkatëse, në bazë të legjislacionit të tyre dhe Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Si përfundim, legjislacioni kombëtar përcakton se në vendin e origjinës nuk mund të ketë dallime thelbësore në procedurën e njohjes. Përvoja ka treguar se duhet të ketë një qasje që zbatohet rast pas rasti për të përcaktuar nëse ekzistojnë dallime thelbësore. Duhet të promovohen qëndrime fleksibël, ndërkohë që duhet t’u largohemi interpretimeve të ngurta të Konventës së Lisbonës me synim arritjen e një qëllimi të përbashkët drejt zbatimit të plotë të Konventës.

Nëse nuk mund të kryhet një njohje e plotë, Konventa e Lisbonës dhe e dokumenteve ndihmëse përcaktojnë tri forma të tjera njohjeje: të kushtëzuara, njohje të pjeshme dhe alternative, por që të tria lidhen me arsimimin e mëtejshëm dhe nuk janë të aplikueshme për njohje profesionale. Kjo do të thotë se nëse ka një ndryshim thelbësor në lidhje me rezultatet e të nxënit, mbajtësi i kualifikimit duhet të këshillohet, të aplikojë për njohje akademike dhe të vazhdojë arsimin në Republikën e Shqipërisë, për të marrë një kualifikim të plotë për një akses në tregun e punës.

Duke pasur parasysh procedurën e njohjes së të drejtave profesionale që kualifikimi ka në vendin e origjinës, praktika ka treguar se problemi kryesor në procesin e njohjes, i cili mund të na drejtojë në ndryshime thelbësore të vendimmarrjes, është statusi i institucionit në vendin e origjinës, ose të vendit ku është ofruar edukimi. Nëse konfirmohet një ndryshim thelbësor, lëshohet një vendim negativ njohjeje.

Komunikimi i rezultatit të procedurës

Pasi është bërë vlerësimi i kualifikimit, hapi i fundit në njohje është nxjerrja e vendimit të njohjes i cili mund të jetë pozitiv ose negativ.

Megjithatë, pavarësisht nëse vendimi për njohjen miratohet apo refuzohet, mbajtësi i kualifikimit duhet të informohet për rezultatin e procedurës së njohjes dhe ai/ajo ka të drejtën e ankimit përpara fillimit të ndonjë procesi gjyqësor. E drejta e ankimit është dispozita kryesore

dhe shtylla e Konventës së Lisbonës. Të gjitha arsyet për vendimin e njohjes duhet të paraqiten në mënyrë eksplicite në vendimin e njohjes, sidomos dallimet thelbësore që çojnë në mohimin e njohjes. Kjo do të thotë që mbajtësi i kualifikimit mund të apelojë vendimin edhe nëse vendimi i njohjes është miratuar, sepse ekziston mundësia që faktet kryesore mbi kualifikimet nuk janë vendosur në mënyrën e duhur në një fazë vlerësimi të procedurës së njohjes. Për shembull, mund të ndodhë që kualifikimi i arsimit të lartë të mos jetë pozicionuar në mënyrë të përshtatshme, ose kohëzgjatja e programit të studimit nuk është e barabartë me kohëzgjatjen nominale të programit të studimit, ose një numër kreditesh të fituara nuk korrespondojnë me kreditet reale të marra etj. Në të gjitha rastet kur mbajtësit e kualifikimit nuk pajtohen me vendimin e njohjes, ata duhet të kenë mundësinë për të apeluar kundër tij. Mbajtësit e kualifikimit duhet të informohen për arsyet e vendimit dhe mundësinë e ankimimit kundër tij. Në rastin e apelit, të gjitha informacionet e dhëna duhet të rishqyrtohen tërësisht nga fillimi. Kur shihet e nevojshme, mbajtësit të kualifikimit mund t'i kërkojnë dokumente shtesë që nuk janë prezantuar ende (ose janë dhënë në mënyrë të pamjaftueshme), ose të kryhen kërkime më të thelluara.

Rekomandohet që organi përgjegjës për shqyrtimin e ankesës nuk duhet të jetë i përbërë nga punonjës që ishin të përfshirë në marrjen e vendimit për njohje. Në rast se edhe organi i shkallës së dytë konfirmon vendimin e njohjes, mbajtësi i kualifikimit duhet të informohet për mundësitë për të kërkuar të drejtat e tij, nëse është ende i pakënaqur me vendimin e marrë nga organi i shkallës së dytë (p.sh. mundësia për procedurë gjyqësore).

Udhëzime për njohjen e kualifikimeve të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe personave në një situatë të njëjtë me refugjatët

Panoramë e përgjithshme

Kriza globale e refugjatëve, me një numër marramendës, 108,4 milionë sipas UNHCR-së të individëve të zhvendosur kërkon vëmendje urgjente ndërkombëtare. Refugjatët përballen me vështirësi për pjesëmarrjen në shoqëritë pritëse për shkak të aksesit të kufizuar në arsim dhe shërbime sociale. Për të përballuar këtë sfidë, një zgjidhje gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme kërkon përpjekje të koordinuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Bashkëpunimi ndërmjet qeverive, organizatave dhe komuniteteve është thelbësor për krijimin e një mjedisi që nxit edukimin dhe aftësimin për refugjatët. T'u njohësh mundësinë refugjatëve që të arsimohen, veçanërisht në shfrytëzimin e kualifikimeve përtej kufijve, është çelësi për integrimin e tyre të suksesshëm në shoqëri. Një qasje e unifikuar botërore është jetike për ta kthyer krizën e refugjatëve në një mundësi për fuqizim, elasticitet dhe prosperitet të përbashkët.

Rëndësia e njohjes në Shqipëri

Njohja e kualifikimeve luan një rol thelbësor në lehtësimin e vijimit të pandërprerë të arsimit të refugjatëve dhe integrimin e tyre nëpërmjet mundësive të punësimit. Në nivel rajonal, vendet nënshkruese të Konventës së Lisbonës janë angazhuar të hartojnë procedurën për njohjen e kualifikimeve të refugjatëve, siç përshkruhet në Nenin VII.

Duke nënvizuar rëndësinë e këtij angazhimi, një draft politikash nga Raporti Global i Monitorimit të UNESCO-s për vitin 2019, thekson se përfitimet arsimore nuk mund të analizohen plotësisht nëse kualifikimet e fituara para migrimit nuk mund të njihen ndërkombëtarisht. Kjo çështje veçanërisht është për refugjatët, të cilët shpesh nisin rrugëtime të rrezikshme duke ikur nga vendet e tyre, duke u përballur me sfida të shumta, në dokumentimin e arritjeve të tyre arsimore.

Kjo paraqet një sfidë të pazakontë për institucionet arsimore, pasi refugjatët shpesh hasin vështirësi në përmbushjen e kërkesave standarde të dokumentacionit, duke i penguar ata që t'u nënshtrohen procedurave të zakonshme për vlerësimin e kualifikimeve. Në këtë kontekst, kur u referohemi refugjatëve, ne përfshijmë personat e zhvendosur dhe individët në situata të njëjta me refugjatët. Një element i përbashkët i këtyre dy kategorive është dokumentimi joadekuat i kualifikimeve të tyre, duke e bërë të vështirë të vërtetohen arritjet e tyre arsimore me provat shkresore të nevojshme.

E domosdoshme është të krijohen mekanizma që sigurojnë se pamundësia e refugjatëve për të dokumentuar kualifikimet e tyre nuk e pengon gjithëpërfshirjen në arsim dhe punësim. Trajtimi i kësaj çështjeje përfshin zbatimin e sistemeve të njohjes, të përshtatura për të kategorizuar kualifikimet e dokumentuara në mënyrë joadekuate. Duke vepruar kështu, ne mund të lehtësojmë procedurat e integritit të refugjatëve në institucionet arsimore dhe në tregun e fuqisë punëtore, sipas rrethanave unike me të cilat refugjatët përballen dhe duke ofruar mundësi të barabarta për zhvillimin e kontributit të tyre të vazhdueshëm në shoqëri.

Situata që mbizotëron sistemin arsimor ka nënkuptime të gjera, duke përfshirë aktorë të shumtë me role kritike në njohjen e kualifikimeve të refugjatëve. Agjencitë kombëtare të njohjes gjenden gjithnjë e më shumë përballë kualifikimeve të dokumentuara në mënyrë të paplotë, duke kërkuar një mënyrë për të ofruar trajtim të drejtë dhe jo diskriminues për të gjithë aplikantët. Dokumentimi i sfidave aktuale kërkon hartimin e procedurave efektive dhe bashkëkohore të njohjes.

Në sferën e institucioneve të arsimit të lartë, situata urgjente është e dukshme. Ekziston një nevojë urgjente me burime praktike, në identifikimin e studentëve potencialisht të pranueshëm, duke përfshirë ata me kualifikime të dokumentuara në mënyrë joadekuate. Institucioni i procedurave përkatëse për këtë grup specifik aplikantësh, u mundëson institucioneve të arsimit të lartë të sigurojnë kushte të barabarta për identifikimin e talenteve, bazuar në parimet e trajtimit të barabartë. Kjo, nga ana tjetër, u ofron të gjithë aplikantëve një mundësi praktike për t'u zhvilluar me aftësitë e tyre dhe duke fituar mundësinë për studime të mëtejshme.

Ministritë shfaqen gjithashtu si një palë interesi kryesor në këtë proces të shumanshëm. Rëndësia e tyre qëndron në ofrimin e institucioneve arsimore me burimet dhe mbështetjen e nevojshme duke kontribuar në mënyrë aktive në zhvillimin e zgjidhjeve të qëndrueshme shumëkombëtare për krizën e vazhdueshme të refugjatëve. Duke njohur përgjegjësinë kolektive, të ndarë, nga këto palë të interesuara, një përpjekje e përbashkët është thelbësore për të krijuar shtigje që jo vetëm prezantojnë sfidat e menjëhershme, por gjithashtu kontribuojnë në unifikimin afatgjatë dhe suksesin e refugjatëve në panoramën arsimore. Kjo qasje bashkëpunuese citon rëndësinë e nxitjes së përfshirjes, mundësive të barabarta dhe një mjedisi mbështetës, për ata që kërkojnë progres arsimor mes vështirësive.

Udhëzimet dhe Burimet

Lidhur me njohjen e refugjatëve, personave të zhvendosur dhe personave në një situatë të ngjashme me refugjatët, Seksioni VII, Neni VII i Konventës së Lisbonës përcakton si më poshtë:

“Çdo palë duhet të ndër marrë të gjitha hapat e mundshëm dhe të arsyeshëm brenda kuadrit të sistemit arsimor të tij dhe në përputhje me kushtetutën, ligjin dhe dispozitat rregullatore për të hartuar procedura të aksesit në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë, nëse përmbushen kërkesat përkatëse për akses në arsimin e lartë për refugjatët, në programet arsimore të arsimit të lartë ose të punësimit, për personat në lëvizje dhe personat në një situatë të ngjashme me refugjatët, gjithashtu edhe në rastin kur dokumenti i kualifikimit i lëshuar nga autoritetet përkatëse nuk mund të verifikohet shkresërisht.”

Për më tepër, "Rekomandimi për njohjen e kualifikimeve të refugjatëve sipas Konventës së Lisbonës dhe Memorandumit Shpjegues", miratuar nga Komiteti i Konventës së Lisbonës në vitin 2017 përcakton si më poshtë:

“Vlerësimi i kualifikimeve të dokumentuara në mënyrë joadekuate duhet të bazohet në informacione të mbledhura nga burime të besueshme publike si dhe nga kandidati që aplikon për njohjen e diplomave të tij dhe duhet, sipas rastit, të plotësohen nëpërmjet intervistave me aplikantin, certifikimeve dhe çdo gjëje tjetër të përshtatshme për metodat e vlerësimit”.

Gjithçka vërtetohet edhe në dokumente të ndryshme evropiane në mënyrë që në bazë të Konventës së Lisbonës, duhet të zbatohet një procedurë e veçantë për njohjen e këtyre grupeve vulnerabël. Në edicionin e dytë të Manualit të Zonës Evropiane të Njohjes, rekomandohen dy qasje të ndryshme:

- qasje në tavolinë, ku informacioni i kërkuar dhe i verifikuar gjendet me kërkim në sekretari. Ky hulumtim në sekretari përmban, përveç informacionit që përmban vendimi i njohjes, informacionet e nevojshme shtesë për krijimin e dosjes. Një informacioni i tillë është një ID studenti, transkript, certifikatë shkolle, certifikatë arritjesh nga institucioni i arsimit të lartë, dëshmitë e përvojës së punës duke përfshirë, nëse të përshtatshme, informacion mbi kualifikimet e marra, çdo dëshmi tjetër duke përfshirë emrat e pedagogëve, përshkrimin e kurseve, deklaratat e pedagogëve mbi mbajtësin e kualifikimit, etj.

- metoda e dytë krahas qasjes në tavolinë përdor intervistën me mbajtësin e kualifikimit në mënyrë që të mbledhë informacionin shtesë të nevojshëm për një vlerësim të arritjeve arsimore.

Krahas këtyre dy metodave, dhe në rast dyshimi të arsyeshëm, mund të kryhen hulumtime shtesë, por për këtë qasje nevojitet staf shtesë i kualifikuar jashtë zyrave (p.sh., profesorë në institucione të arsimit të lartë, ekspertë në fusha të ndryshme), të cilët përgatisin dhe zhvillojnë provimet.

Peizazhi i tanishëm citon domosdoshmërinë kritike për udhëzime konkrete që kanë të bëjnë me njohjen e kualifikimeve të refugjatëve. Udhëzimet praktike janë të rëndësishme në pajisjen e institucioneve me hapa veprues për të shpërfaqur sfidat e prekshme dhe zbatimi i procedurave gjithëpërfshirëse në nivel institucional, shërben si një katalizator për ndërtimin afatgjatë të kapaciteteve. Këto udhëzime, të përshtatura posaçërisht për njohjen e kualifikimeve të mbajtura nga refugjatët, personat e zhvendosur dhe ata në situata të njëjta me refugjatët, u japin institucioneve arsimore një kornizë të përmbledhur parimesh dhe burimesh të përbashkëta.

Duke nënvizuar rëndësinë e këtij angazhimi, një draft politikash nga Raporti Global i Monit-Tetë parime themelore janë të përfshira në udhëzimet për njohjen e kualifikimeve të refugjatëve. Këto parime shërbejnë si një plan themelor, duke udhëhequr institucionet arsimore në zhvillimin e procedurave sistematike të njohjes. Gjithashtu, janë identifikuar burime që mund të luajnë një rol kryesor në thjeshtëzimin e aplikimit të këtyre parimeve. Këto burime janë krijuar për të ofruar ndihmë praktike dhe mbështetje strategjike, duke fuqizuar institucionet për të analizuar peizazhin e ndërlikuar të njohjes së kualifikimeve brenda kontekstit unik të refugjatëve dhe personave të zhvendosur.

Në thelb, këto udhëzime dhe burime nuk janë thjesht masa urdhëruese, por përfaqësojnë një qasje tërësore për aplikimin e zgjidhjeve të qëndrueshme. Duke përqaftuar këto parime dhe duke përdorur burimet e identifikuar, institucionet arsimore mund të konsolidojnë procedurat e tyre të njohjes, duke promovuar gjithëpërfshirjen, barazinë dhe frytshmërinë. Kjo përpjekje kolektive kontribuon jo vetëm në zgjidhjen e menjëhershme të problemeve, por edhe në rritjen e qëndrueshme të kapaciteteve institucionale, duke pohuar kështu një angazhim për avancimin arsimor dhe integrimin e personave të prekur nga zhvendosja dhe strehimi. Në përputhje me rekomandimet e Këshillit të Evropës në projektin MERIC-Net në vitin 2020 dhe paketën e mjeteve të hartuara nga NOKUT në vitin 2017, tetë parime përfaqësojnë udhëzimet për njohjen e kualifikimeve të refugjatëve dhe 5 burime në ndihmë të përmbushjes së këtyre parimeve janë identifikuar nëpërmjet zhvillimit të procedurave sistematike të njohjes.

Udhëzimet

- 1. Aksesueshmëria:** Në realizimin e procesit të njohjes, është thelbësore të sigurohet që asnjë aplikant të mos pengohet në vlerësimin e kualifikimeve, qoftë për shkak të kufizimeve financiare, mungesës së informacionit mbi qasjen në vlerësime, çështjeve të aftësisë gjuhësore ose mungesës së procedurave specifike për aplikantët me kualifikimet e dokumentuara në mënyrë të pamjaftueshme.
- 2. Sigurimi i informacionit:** Aplikantët duhet të marrin informacion të plotë për qasjen në shërbim, detaje rreth procesit, informacion mbi rezultatet, përditësime të statusit mbi vendimet dhe udhëzime në rrugëtimin e tyre.
- 3. Trajtimi i barabartë:** Për të garantuar që aplikantët me dokumentacion të pamjaftueshëm ose pa dokumentacion të kenë një mundësi të mirëfilltë për vlerësimin e kualifikimit, pengesat si pengesat gjeografike, gjuhësore, financiare dhe sociale nuk duhet të pengojnë askënd që të vlerësojë kualifikimet e tij.
- 4. Trajtimi i duhur:** Individët që janë refugjatë, persona të zhvendosur ose në një situatë të njëjtë me refugjatët kanë të drejtën që kualifikimet e tyre të vlerësohen nga një autoritet kompetent njohjeje.
- 5. Efektiviteti:** Aplikimet duhet të trajtohen me shpejtësi për të siguruar frytshmëri në procesin e njohjes.

6. **Transparenca:** Procedurat dhe kriteret për vlerësimin e kualifikimeve të dokumentuara në mënyrë joadekuate duhet të jenë të qarta, të qëndrueshme dhe të besueshme.

7. **Rëndësia:** Vlerësimi përfundimtar duhet të pranohet gjerësisht në tregun e punës, për studime të mëtejshme dhe forma të tjera njohjeje ose autorizimi brenda Komunitetit Evropian. Gjithashtu, metodologjia e vlerësimit duhet të jetë e përshtatshme për refugjatët e sapoardhur, duke përfshirë ata me aftësi gjuhësore të limituara në anglisht ose në gjuhët lokale.

8. **Lëvizshmëria:** Sigurimi që deklarata përfundimtare të jetë një dokument i standardizuar i pranuar nga të gjitha shtetet palë në Konventën e Lisbonës është thelbësore. Kjo shmang nevojën që autoritetet publike të dyfishojnë vlerësimet e kryera tashmë nga autoritetet përkatëse të shteteve të agjencive të tjera. Dokumenti duhet të lëshohet në një gjuhë të folur gjerësisht, së bashku me një dokument në gjuhën lokale.

Burimet

1. **Një tablo gjithëpërfshirëse** që katalogon dosjet e refugjatëve sipas vendit, e renditur sipas rendit kronologjik të mbërritjes, thjeshton vlerësimin me prioritet nga vlerësuesit.

2. **Bazat e të dhënave** për vendet individuale që përmbajnë informacion mbi sistemet arsimore dhe statusin e institucioneve arsimore.

3. **Informime rreth shteteve** të përshtatura posaçërisht për refugjatët, duke ofruar informacion konciz dhe përkatësisht thelbësor rreth vlerësimeve në vendet përkatëse të origjinës.

4. **Listat e kontakteve**, një proces që siguron dhënien e saktë të kualifikimeve, ku përfshihet konfirmimi nga autoriteti lëshues i tij. Në rast se verifikimi nuk mund të kryhet nga faktorë të tillë si arkiva e shkatërruar ose mungesa e të dhënave, dalim në përfundimin e një dokumenti të paverifikueshëm.

5. **Përdorimi i një liste kontrolli për vlerësuesit e kredencialeve**, duke ofruar një pasqyrë të strukturuar të pikave kyçe që duhen prezantuar gjatë procesit të vlerësimit të kualifikimit.

6. **Projektet EQPR/UQP**, ridrejtoni personat pa dokumentacion dhe informojini se si duhet të regjistrohen dhe të aplikojnë për pasaportat e kualifikimeve.

Vendosja e procedurave tona mbi këtë grup parimesh dhe burimesh mund të garantojë një zgjidhje që ofron trajtim profesional dhe plotëson nevojat institucionale për të gjithë palët e interesuara. Pavarësisht nga legjislacionet dhe praktikat e ndryshme të vlerësimit në vende të ndryshme, baza e procedurave tona në parime të përbashkëta siguron që rezultati i vlerësimit të sigurojë informacionin e nevojshëm dhe përkatës për marrjen e vendimeve përfundimtare të mirë menduara. Kjo qasje ruan gjithashtu standarde të larta profesionalizmi, duke krijuar një zgjidhje të dobishme për të gjithë palët e interesuara. Kjo siguron identifikimin e hershëm të aftësive dhe kompetencave të refugjatëve. Për të arritur këtë objektiv të përbashkët, ne duhet të zbatojmë procedura më fleksibël dhe të standardizuara për ata që nuk janë në gjendje të dokumentojnë plotësisht kualifikimet e tyre. Rrjedhojë thelbësore është zhvillimi i procedurave sistematike të bazuara në parimet dhe sigurinë që rezultati i vlerësimit të japë informacion të vlefshëm, e ndërkuftar.

Pasaporta e Kualifikimeve për Refugjatët pasqyron një aplikim gjithëpërfshirës dhe sistematik të këtyre parimeve, duke kulmuar në një deklaratë këshilluese të kualifikuar që specifikon kualifikimin(et) e refugjatit. Ky dokument i standardizuar, jo vetëm që përmbledh informacion mbi nivelin arsimor, përvojën e punës dhe aftësinë gjuhësore të aplikantit, por gjithashtu ofron udhëzime të kualifikuara për procedurat e mëtejshme që mund të ndiqen. Rrjedhimisht, dokumenti ofron njohuritë e duhura mbi sfondin arsimor dhe trajnimin e refugjatëve, duke ofruar mbështetje të vlefshme për punësim dhe aplikime arsimore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Dhjetor 2023



ENIC-NARIC

rruga për njohjen e diplomave të huaja



European
Commission

